



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0978

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Termo Solar Engineering SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komunës së Klinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive ne Komunen e Klinës- Ndërtimi i nxemjes qendrore ne budisalc" me numër të prokurimit 634-23-11434-5-2-1, me 29/01/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Termo Solar Engineering" SH.P.K. me nr. 2023/0978, e datës 04/12/2023, kurse vendimi i AK Komuna e Klinës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive ne Komunën e Klinës- Ndërtimi i nxemjes qendrore ne budisalc" me numër të prokurimit 634-23-11434-5-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Termo Solar Engineering SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.10.2023 Komuna e Klinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive ne Komunën e Klinës- Ndërtimi i nxehjes qendrore ne budisalc" me numër të prokurimit 634-23-11434-5-2-1.

Ndërsa me datën 20.11.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë “Uraniku”.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 28,000.00 €.

Me 27.11.2023 "Termo Solar Engineering" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 29.11.2022, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 04.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Termo Solar Engineering SH.P.K me nr. 978/23 për lidhur me aktivitetin “Renovimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive ne Komunën e Klinës- Ndërtimi i nxehtës qendrore ne budisalc” me numër të prokurimit 634-23-11434-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

- Përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim: “Pretendimi i parë- sigurimi i tenderit nuk qëndron pasi ne policën e sigurimit është e cekur emri i projektit numëri i prokurimit dhe detaje tjera te nevojshëm. Pretendimi i dytë: Për stafin profesional Inxh i makinerisë. Pra nuk qëndron se ne kemi kërkuar inxh te makinerisë apo te profilit te ngrohjes. po ashtu për stafin tjetër (mjeshtrë) kemi kërkuar listën kontrata apo parakontratë. Për realizimin e kontratave te natyrës se ngjashme. Nuk qëndron pasi ne listën e paraqitur se bashku me referencat O.E e ka plotësuar kriterin minimal qe është $1.5 \text{ pra qe i bije } 28.000 \times 1.5 = 42,000.00 \text{ euro}$ pra referenca te cilat ne si autoritet kontraktues i kemi marre për baza janë: AFK: viti 2020 vlera 23,331 euro; AFK: viti 2021 vlera 15,964 euro. KKD: viti 2022 vlera 9,301 euro- total 48,578 euro pa kërkuar sqarime tjera. Pretendimi i pa bazuar pasi ju si OE jeni eliminuar si oferte e pa përgjegjshme pasi: Gjate rivlerësimit është konstatuar se në ofertën tuaj për pos qe nuk e keni kamijoneten konform. Kërkesave te DT ju nuk i keni te noterizuar as kontrata apo para kontrata e inxhinierëve. Po ashtu librezat e qarkullimit apo marrëveshjet për shfrytëzim te mjeteve Labinot Morina.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik Ankues OE “Termo Solar Engineering” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi i parë (I), Ankuesi pretendon se:* “Me dt.20.10.2023 është publikuar njoftimi për kontratë, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt.30.10.2023 ku kanë marr pjesë 3 operator ekonomik. Me dt.09.11.2023 nxjerret njoftimi mbi vendimin (B58) ku ne jemi rekomanduar për kontratë. Më pastaj është parashtruar kërkesë për rishqyrtim nga OE “Uraniku-SG SH.P.K” dhe lënda është kthyer në rishqyrtim nga ana e autoritetit kontraktues. Me dt.20.11.2023 përmes platformës elektronike E-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e ri të

AK-së, ku autoriteti kontraktues pas rishqyrtimit të lëndës e ka rekomanduar për kontratë OE "URANIKU-SG SH.P.K, ndërsa neve na ka shpallur si tenderues i eliminuar me arsyetimin se. "Nuk keni paraqitur dëshmi për kamioneten sipas kërkesës në dosje të tenderit". Në lidhje me këtë arsye të eliminimit, ju sqarojmë se tek neni 9.1&9.2 të FDT-së është kërkuar: "Kërkesa - mjete te punës te disponohem për OE a)kamionët për bartje te materialit dhe punëtoreve min. 1 cope c) pikup për punëtorë min. 1 cope\kurse dëshmi dokumentare është kërkuar "Dëshmia -10 lista e mjete te punës te e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Dëshmi librezja e regjistrimit valide e noterizuar, ose mund te mirren me qera për këtë projekt me marrëveshje te noterizuar". Në lidhje me këtë kërkesë, ne kemi ofruar dëshmi për një kamion kiper me dy dyer në emër të anëtarit të konsorciumit Seti Commerce, prandaj në këtë rast është përmbushur kërkesa në fjalë- Madje kamioni është më shumë i domosdoshëm në këtë projekt se sa kamioneta. Në këtë rast me rëndësi është te ofrohen dëshmi për mjet transporti dhe nuk ka rëndësi pesha e mjetit sepse nuk ka ndonjë vend të ngushtë apo ndonjë vend specifik që do të nevojitej domosdoshmërisht kamioneta. Pra ky fakt përbën devijim të vogël sipas nenit 59.4 pika (ii) sepse nuk përbën ndonjë ndryshim material e as substancial në këtë rast. Ne kemi pasur qasje në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe kemi vërejtur se ky OE është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim: OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse sigurimin e tenderit nuk e ka ofruar sipas nenit 57 të LPP-së dhe aneksit 4 të dosjes së tenderit ku është përcaktuar si në vijim: andaj ne, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të tenderuesit, deri në një total prej: < shuma e sigurisë me fjalë dhe shifra > zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim: a. Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhënë informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues; b. Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit; c. Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon: • Që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit; • Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo • Të lidhë kontratë që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuara në dosjen e tenderit. Pa kushtet e lartcekura nëse eventualisht do të vije deri të situata kur duhet të konfiskohet sigurimi, atëherë autoriteti kontraktues nuk mund të kërkojë të konfiskohet sigurimi i tenderit. Në këto raste nuk mund dhe nuk duhet të kërkojen as sqarime shtesë nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, kurse këtë fakt e parasheh neni 10 i Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik ku shkruan: Sigurimi i Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT- Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm".

- *Pretendimi i dytë (II):* "OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse Certifikatat dhe kualifikimet e instaluesve te ngrohjes i mungojnë-Në nenin 9.1&9.2 të FDT-së është kërkuar: Kërkesa OE duhet te jete i pajisur me certifikata ISO 9001 ISO 45001 ISO 14001 Ndërsa stafi me kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personelit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushën përkatëse, se paku një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, dhe një (1) inxhinier makinerisë apo te profilit te nxemjeve qendrore. OE apo ing tjetër te emërtuar me vendim Menaxher te Kontratës. Staf tjetër min 5, te punësuar te përhershëm apo me kontrata për kohe te caktuar .Regjistri dhe kontratat te kualifikuar mjeshtër. Dëshmi dokumentare është kërkuar: Dëshmia .Për certifikimet certifikatat kopje ndërsa për stafin profesional injjinerat Të dëshmohet me CV te

nënshkruar nga vet ing, diplomë, e kualifikimit kontratë pune apo parakontrat për angazhim ne këtë projekt. Te noterizuara duhet te jene diploma kontrata apo parakontrat për këtë projekt jo me te vjetra se 1 vite (noterizimi). Deri sa për fuqinë punëtore te angazhuar duhet te jepet regjistri kualifikimet, kontrata apo parakontrata. Për mjeshtrit që i ka cekur në listë të punëtorëve, nuk është ofruar asnjë dëshmi e kualifikimit, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet nga konkurrenca. OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofruar dëshmi për Inxhinierin e makinerisë se është i diplomuar në drejtimin e termoenergjetikës por ka ofruar dëshmi se është i diplomuar në drejtimin e prodhimit të . Pra inxhinieri i makinerisë Valdet Shala nuk e ka drejtimin përkatës termo energjetik siç është kërkuar ne dosjen e tenderit. Në FDT është kërkuar: një (1) inxhinier makinerisë apo te profilit te nxemjesve qendrore. Duke pasur parasysh këtë kërkesë dhe dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë kuptohet qartë se ky OE nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Në lidhje me kontratat e realizuara nga OE i rekomanduar për kontratë janë ofruar referencat, por për referencat me kompani private mungojnë fletëpagesat dhe dëshmitë bankare, prandaj nuk dihet se a janë realizuar me të vërtetë këto kontrata me kompani private. OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një listë të kontratave e ku është shënuar data e fillimit dhe e përfundimit të kontratave. Po ashtu janë ofruar disa referenca në lidhje me këto kontrata por që sipas referencave dhe datave të lëshimit të tyre nuk dihet saktë se kur kanë përfunduar kontratat, prandaj nuk mund të merret parasysh data e lëshimit të referencës si datë finale e përfundimit të kontratës. Dihet që shumë referenca lëshohen ndoshta edhe me një ose dy vite mbrapa përfundimit të projekteve varësisht se kur i nevojiten operatorëve ekonomik. Referenca e lëshuar nga Aldex shkruan se punimet deri më tani janë realizuar në vlerën prej 149, 520.00 €. Nga ky tekst kuptohet se kjo kontratë nuk është e përfunduar prandaj nuk mund të merret parasysh dhe nuk është sipas kërkesës së FDT-së, e ku është kërkuar kontrata të përfunduara. Ne disa kontrata të lidhura me punëtorët numri i biznesit është shënuar 810409017, ndërsa numri real i biznesit të OE të rekomanduar për kontratë është 810409012, prandaj këto kontrata janë të pavlefshme. Autoriteti kontraktues ka nxjerr vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt.30.11.2023. Në lidhje me sigurimin e tenderit të OE të rekomanduar për kontratë, autoriteti kontraktues e ka cekur se është e shënuar emri i projekt, numri i prokurimit dhe detaje tjera, prandaj në këtë rast kemi shmangie nga pretendimi jonë ankimor se sigurimi i tenderit nuk i përmban kushtet e sigurimit. Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë asnjë sqarim detal në lidhje me pretendimet tona ankimore por vetëm ka qëndruar mbrapa njoftimit mbi vendimin e tyre. Në lidhje me ofertën tonë, tani është munduar që të gjejë edhe arsye tjera apo mangësi të ofertës tonë, mirëpo ne nuk mund ti komentojmë këto sepse nuk kanë qenë arsye të eliminimit e po ashtu edhe janë të paqëndrueshme këto pretendime. Kërkojmë nga OSHP-ja që t'i analizoj në tërësi pretendimet tona ankimore dhe njëkohësisht ti analizoj dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe të nxjerr një përfundim konkret në lidhje me pretendimet tona ankimore. Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet qe u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i pa përgjegjshëm, ndërsa ne jemi eliminuar në mënyrë të kundërligjshme. Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Ne jemi ofertues më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit, e po ashtu jemi edhe OE i përgjegjshëm. Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7

të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që “Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse”, mirëpo AK-së nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, pasi që është rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm. Autoriteti kontraktues është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 dhe 6 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë”.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 978/23, ndërsa me datë 14.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0978 me rekomandimet si në vijim: “*Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet Vendimi i AK për kualifikimin e Operatorëve Ekonomik dhe rekomandon që lënda të kthehet në rishqyrtim*”.

Lidhur me pretendimet e “Termo Solar Engineering” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0978 ka vlerësuar si në vijim:

- *Konstatimi i parë (I):* “Eksperti Shqyrtues sqaron pretendimi 1. Duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, duke u bazuar në DT, Kërkesën - mjete të punës të disponohem për OE a) kamionët për bartje të materialit dhe punëtorëve min. 1 cope c) pikup për punëtorë min. 1 cope. Dëshmia -10 lista e mjeteve të punës të nënshkruar dhe vulosur nga OE. Dëshmia librezë e regjistrimit valide e motorizuar, ose mund të mirren me qira për këtë projekt me marrëveshje të motorizuar, duke u bazuar në kërkesën e AK-së është në diskrecion të AK-së për të caktuar devijimet e vogla që të vlerësoj në bazë të LPP-së nenit 59.4, AK (Autoriteti i Kontratës) nuk ka specifikuar peshën e kamionëtës dhe për mendimin e ekspertit shqyrtues ky pretendim është pjesërisht i bazuar”.
- *Konstatimi i dytë (II):* “Eksperti Shqyrtues sqaron pretendimi 2. Duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, duke u bazuar në DT Aneksi 4, Kërkesën Siguria e tenderit OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një polisë sigurimi për këtë procedurë në po ju ofrojmë policën e sigurimit të ofruar nga OE dhe pjesën e Aneksit 4 të DT –së”. Duke e parë Aneksi 4 të dosjes së tenderit dhe Policë e Sigurimit të ofruar nga OE në fjalë vërejmë se ka një mos përputhje dhe është në përgjegjësi të Autoritetit kontraktues që të vlerësoj në konform LPP -së nenit 59. Duke u bazuar në atë që kemi sqaruar më lartë ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar dhe të njëjtën kohë rekomandojmë që lënda të kthehet në ri vlerësim.
- *Konstatimi i tretë (III):* “Eksperti Shqyrtues sqaron pretendimi 3. Duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës dhe duke u bazuar në kërkesën e AK-së në FDT Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 O.E duhet të jete i paisur me certifikata ISO 9001 ISO 45001 ISO 14001 Ndërsa stafi me kualifikimet shkollore dhe profesionale të

personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personelit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Staf i kualifikuar në fushën përkatëse, se paku një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, dhe një (1) inxhinier makinerisë apo te profilit te nxemjesve qendrore. OE apo ing tjetër te emërtuar me vendim Menaxher te Kontratës. Staf tjetër min 5, te punësuar te përhershëm apo me kontrata për kohe te caktuar. Regjistri dhe kontratat .t te kualifikuar mjeshtër. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia. Për certifikimet certifikatat kopje ndërsa për stafin profesional ingjinerat. Të dëshmohet me CV te nënshkruar nga vet ing diplomë, e kualifikimit kontratë pune apo parakontrat për angazhim në këtë projekt. Te noterizuara duhet te jene diploma kontrata apo parakontrat për këtë projekt jo me te vjetra se 1 vite (noterizimi). Deri sa për fuqinë punëtore te angazhuar duhet te jepet regjistri kualifikimet, kontrata apo para kontrata. Në bazë të ofertës së Operatorit Ekonomik (OE), e cila është e rekomanduar për kontrate, ka paraqitur një listë e punëtoreve. Kjo listë përfshin emrat, mbiemrat, përgatitjen shkollore (nivele e arsimit), pozitën dhe përvojën e punës për secilin kandidat/punonjës. Përveç kësaj, OE ka paraqitur edhe kontrata valide pune për secilin kandidat/punonjës. Pas vlerësimit të kësaj oferte dhe pas analizës së mendimit të ekspertit shqyrtues, del se pretendimi ankimor i paraqitur është i pa bazuar në faktet dhe rrethanat e paraqitura.

- *Konstatimi i katërt (IV):* “Eksperti Shqyrtues sqaron pretendimi 4. Duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës dhe duke u bazuar në kërkesën e AK-së në FDT Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 një (1) inxhinier makinerisë apo te profilit te nxemjesve qendrore, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një inxhinier të diplomuar në Universitetin e Prishtinës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike z. Valdet Shala Inxhinier i Diplomuar i Makinerisë, megjithatë AK nuk ka specifikuar drejtim specifik dhe duke u bazuar në kërkesën e AK-së dhe në dëshminë e ofruar nga OE për mendimin e ekspertit ky pretendim ankimor i paraqitur është i pa bazuar”.
- *Konstatimi i pestë (V):* Eksperti Shqyrtues sqaron pretendimi 5. Duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës dhe duke u bazuar në kërkesën e AK-së në FDT Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kërkesa - Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka kryer se paku 42.000.00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me sukses të këtyre projekteve. Referencat e bashkangjitura dhe kontrata e përfunduara te natyre se njëjtte në periudhën 36 muajt e fundit para datës së njoftimit me kontratë. Dëshmia– Te dorëzoni listën e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjashme të realizuara periudhën 36 muajt e fundit para datës e publikimit te njoftimit për kontrate, dhe dëshmitë e përfundimit me Referencat ose procesverbalet e pranimit teknik apo raportet përfundimtare për pranimin e punëve të kryera Në vlerat e kërkuara nga Periudha e kërkuar. Nga kontratat e nënvizuara vlerësojmë se OE e arrinë kërkesën e AK-së për punë të ngjashme, dhe bazuar në këtu që u cekën më lartë vlerësojmë se ky pretendim ankimor i paraqitur është i pa bazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar pjesërisht lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrirat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha

ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se AK nuk vepruar konform dispozitave të cituara si më sipër, të precizuara dhe të argumentuara ato në ankesë dhe në raportin e ekspertit shqyrtues. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Raporti i ekspertit shqyrtues nuk prodhon efekte detyruese për asnjërën nga palët dhe as për panelin shqyrtues, prandaj i njëjti (natyrisht dhe vlerat provuese të tij) gjithnjë analizohen në raport me të gjitha shkresat e një lënde, me rrjedhën e procesit të prokurimit, veprimet e palëve, qëllimin dhe natyrën e një aktivitetit të prokurimit, i cili në parim synon përmbushjen e nevojave publike, me përdorimin e fondeve publike, të cilat i janë besuar secilit AK, në cilin do nivel.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik konkretisht nenin 59 dhe 60 dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Renovimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive ne Komunën e Klinës- Ndërtimi i nxehtës qendrore ne budisalc” me numër të prokurimit 634-23-11434-5-2-1. Andaj aktiviteti i prokurimit duhet të kthehet në ri-vlerësim. Më poshtë, Paneli shqyrtues do të elaboroj vetëm pretendimet ankimore të cilat ishin përcaktuese në vendimarrjen meritore për këtë procedurë.

Lidhur me pohimin ankimore të ankuesit sa i përket eliminimit të tij ku sipas AK nuk ka paraqitur dëshmi për kamionetën sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Lidhur me këtë Eksperti Shqyrtues sqaron se duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, duke u bazuar në DT, Kërkesën - mjete të punës të disponohem për OE a) kamionët për bartje te materialit dhe punëtorëve min. 1 cope c) pikup për punëtorë min. 1 cope. Dëshmia -10 lista e mjete te punës te e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Dëshmia librezë e regjistrimit valide e motorizuar, ose mund te mirren me qira për këtë projekt me marrëveshje te motorizuar, duke u bazuar në kërkesën e AK-së është në diskricion të AK-së për të caktuar devijimet e vogla që të vlerësoj në bazë të LPP-së nenit 59.4, AK (Autoriteti i Kontratës) nuk ka specifikuar peshën e kamionëtës dhe për mendimin e ekspertit shqyrtues ky pretendim është pjesërisht i bazuar. Lidhur me këtë vlenë të potencohet fakti se eksperti shqyrtues nuk e ka elaboruar deklarinimin e palës ankimore se "nuk është ofruar kamionet por ne kemi ofruar dëshmi për një kamion kiper me dy dyer", atëherë për panelin shqyrtues ashtu sikurse për AK, ankuesi në këtë rast nuk e ka plotësuar kërkesën e Dosjes së Tenderit. Por AK, në fazën e ri-vlerësimit në kuptim të nenit 6 të LPP për shkak se oferta ankuesi është më e lirë, atëherë, në bashkëpunim me njësinë e kërkesë i mbetet të verifikoj se kamioni i ofruar a mund të jetë funksionl për nevojat e tyre, nëse po, mbetet në diskrecion të AK të vlerësoj këtë si devijim të vogël, konform nenit 59.4 të LPP.

Lidhur me pohimin ankimore se i rekomanduari duhet eliminuar për shkak të sigurimit të tenderi, cili nuk është prezantuar konform kushteve te parapara me Dosje të Tenderit. Lidhur me sigurimin e ofertës, paneli shqyrtues sqaron se OE ankues ne ofertën e tij, ka ofruar një police sigurimi te emëruar si "Sigurim për Garanci" kurse është kërkuar "Sigurim i tenderit". Ne përmbajtjen e "sigurimit për garanci" vërehet se e njëjta i referohet arsytitimit në rast nuk

ekzekutohet kontrata. Ne vlerësim të panelit shqyrtues kjo dëshmi konkretisht sigurimi i garancionit ka të bëjë me sigurinë e ekzekutimit dhe jo me sigurim të ofertës dhe sipas tabelës së dhënë në Udhëzuesin për prokurim publik, konkretisht në tabelën e dhënë konsiderohet si kusht administrativ dhe se oferta në rast të tilla refuzohet pa kërkuar sqarime të mëtutjeshme. Si rrjedhoh Paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë në vend që të sjell "sigurimin e tenderit" dhe me kushtet e parapara edhe tek Aneksi 4 i Dosjes së Tenderit, ka sjellur një "sigurim që kanë të bëjnë me ekzekutim të kontratës" andaj mbi këtë bazë dhe në konsistencë edhe me vendimet tjera OE i rekomanduar për kontratë nga ana e AK rezulton të jetë i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit, pa nevojë që të elaborohen në detaje edhe pretendimet tjera ndaj të rekomanduarit nga ana e këtij Paneli.

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, Paneli konsideron se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit ka shkelje të dispozitave të cilat janë cituar nga ankuesi, kurse Vendimi i atakuar i AK duhet të anulohet, sepse lënia në fuqi e të njëjtit, atakon në këtë rast qëllimet primare të LPP të sanksionuara me nenin 1 dhe parimet e përgjithshme të këtij Ligji të sanksionuara me nenin 6, sipas të cilit "Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës" lidhur me neni 104 të LPP, sipas të cilit "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës në fjalë".

Në përfundim të gjithë kësaj Paneli vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, nisur nga bindja dhe gjykimi i pavarur i tij se ka aplikuar zgjidhjen e duhur në këtë rast. Raporti i ekspertit shqyrtues (i brendshëm apo i jashtëm) ndonëse nuk është detyrues për Panelet Shqyrtuese të cilat në proceset e vendimmarrjes ushtrojnë pavarësinë e plotë në zbatimin e kompetencave sipas nenit 105 të LPP, i njëjti në çdo rast analizohet dhe i njihet vlera provuese në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të një lënde. Andaj nisur nga kjo paneli shqyrtues vlerëson se aktiviteti i prokurimit, duhet me patjetër të nënshtrohet procesit të rivlerësimit.

- Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i aprovuar në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 dhe 6 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - Termo Solar Engineering SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: